



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 7.10.2008, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Zylfi Merxha, Selvie Halimi, Kosara Nikolić dhe Elheme Hetemi.

**Munguan** : Ibrahim Selmanaj, Myrvete Pantina, Zef Morina, Heset Cakolli, dhe Ali Lajçi.

**Përfaqësuesit nga ministria: Nazim Shkodra, Nezahete Hakaj, Remyush Latifi**

**Nga stafi mbështetës i komisionit** :Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu dhe Lule Ymeri.

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara,**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit,**
- 3. Të ndryshme.**

**Kryesuesi i komisionit** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Kryesuesi**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin pa vërejtje.

**2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit**

**Kryesuesi**, theksoi se para se të fillohet me shqyrtimin e Projektligjit nen për nen, ne si komision do ti dëgjojmë opinionet e përfaqësuesve të Ministrisë së Mjedisit .

**Ismajl Rudari UD** në MMPH- theksoi se Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit është bazik dhe se nga ky ligj dalin shumë ligje që mbulojnë shumë fusha në mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, të cilat fusha i mbulon MMPH. Arsya për plotësimin dhe ndryshimin e Projektligjit është i domosdoshmen, pasi ligjet duhet të jetë në harmoni me direktivat Evropiane dhe ne si Ministri jemi bazuar në direktiva me qëllim që të kemi Ligj të zbatueshëm.

**Kryesusi** – theksoi se komisioni përveç draftit ka marrë edhe disa propozime të grupeve të interesit të cilat do t'i shqyrtojë gjatë procedurës së amendamentimit të Projektligjit me qëllim që të mos miratojmë ligje të cilat janë në kolizion me ligjet që janë në zbatim. Fjalën ia dha raportueses së Projektligjit.

**Selvie Halimi** – pasi Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit është bazik, si komision do të orientohe mi në aspektin profesional dhe do të nxjerrim përfundime sa më të qarta që ligji në praktikë të jetë i zbatueshëm. Si grup punues të gjitha vërejtjet dhe propozimet e marra nga grupet e interesit dhe nga përfaqësues të tjerë nuk është arritur ti shqyrtojmë për këtë periudhë të shkurtër kohore, por në bazë të opinioneve që do të marrim nga përfaqësuesit e ministrisë do të fillojmë me nen për nen shqyrtimin e Projektligji.

Si komision, jemi njoftuar se është arritur një marrëveshje në mes MEM dhe MMPH lidhur me ofiqiencën e energjisë dhe propozoi që të mos hapet edhe një agjencion i veçantë por duhet të mbetet në kuadër të MMPH.

Dispozitat ligjore lidhur me propozimet e ofiqiencës së energjisë se ku duhet të inkorporohen dhe çka duhet të përmbajë kanë arritur nga vetë MMPH dhe nga MEM.

Nga përfaqësuesit e MMPH kërkojmë që nga aspekti profesional të ofrojnë sqarime lidhur me këtë problematikë sepse gjatë ekzekutimit, mund të paraqiten problematika të mëdha.

Sa i përket kërkesës për ndryshim dhe plotësim të ligjit kemi indikatorë të interesave të caktuara të grupeve. Për këtë çështje ne si komision nuk duhet të biem në kundërthënie të grupeve të caktuara, por duhet të nxjerrim ligjin i cili do të jetë i zbatueshëm.

Kërkoj nga MMPH të ofrohen arsyet konkrete lidhur me çështjen e ofiqiencës së energjisë gjithashtu edhe lidhur me Institutin hidrometeorologjik që tani propozohet të largohet nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit.

**Nezafete Hakaj-** sa i përket çështjes së ofiqiencës së energjisë nuk kemi njohuri rreth marrëveshjes në mes të MMPH dhe të MEM. Në bazë të njohurive që kemi brenda Ministrisë, nuk është elaboru çështja se cilës pjesë të Ministrisë do ti takojë ky sektor i cili gjatë punës do të jepte rezultate dhe nuk do të kishte konflikte të interesit me MEM-in.

Agjencioni si departament është krijuar në vitin 2004, por nuk ka funksionuar për arsye të stafit dhe për shkaqe financiare dhe ky sektor ka mbetur i shkruar vetëm në letër. Për këto arsye vjet është bërë nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit.

Në grup punues gjatë hartimit të këtij drafti kanë qenë të involvuar të gjithë sektorët e mjedisit dhe në bazë të praktikave evropiane janë përcaktuar detyrat e Agjencionit.

**Berat Luzha** – tha se për çështjet që u debatuan në mbledhje, Ministrisë i nevojitet kohë shtesë të bëjë krahasimin e propozimeve dhe në mbledhje të ardhshme të vijë me qëndrime konkrete. Gjithashtu edhe komisionit i nevojitet kohë që të bëjë harmonizimin e propozimeve të marra nga 6 grupe punuese, pastaj të fillojë me procedurën e amendamentimit të Projektligjit.

**Kryesusi** – kërkoj nga stafi i Kuvendit të përgatitë me shkrim një formë përmbledhëse të të gjitha propozimeve të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen e datës 13.10.2008 në ora 13:00 në sallën N-10.

### **3. Të ndryshme.**

**Komisioni** - në të ndryshme diskutoi rreth Rekomandimeve për çështjen e parkut Nacional – të fshatit Prevallë të cilat Rekomandime do të shqyrtohen në Seancën Plenare të radhës. U mor qëndrim që pika e parë dhe e fundit e rekomandimeve të mbeten dhe të sugjerohen për seance. Komisioni nuk mori qëndrim lidhur me pikën tjetër e cila do të diskutohet në Seancën Plenare për Pyjet e Deçanit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

*Përgatitur nga*

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit**

---

**Lulzim Zeneli**